



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština -Municipality of Prishtina

Drejtoria e Bujqësisë

### THIRRJE PËR APLIKIM

Furnizimi me kultivatorë për fermerë, prodhues të bimëve mjekësore aromatike - 12 copë, kultivues të perimeve - 21 copë, dhe kultivues të pemëve drufrutore - 21 copë.

#### Kriteret e përgjithshme:

- Përkatën fermerët e vegjël të cilët kultivojnë bimë aromatike mjekësore (BMA), perime në ambient të hapur dhe të mbyllur – serra dhe pemë drufrutore;
- Aplikuesi duhet ta ketë pronën në territorin e komunës së Prishtinës dhe të jetë banor rezident i saj;
- Aplikuesi duhet të ketë sipërfaqe të kultivuar me bimë aromatike mjeksore së paku 0.03 Ha, perime në ambient të hapur dhe të mbyllur-serrë, së paku 0.05 ha, si dhe pemishte (pemë drufrutore) të rregullt, (e lëvruar ose me bari të kultivuar në mes të rreshtave, krasitur, mbrojtur nga sëmundjet dhe dëmtuesit) dhe sistemi i mbjelljes të jetë me renditje të qartë dhe të rregullt të rendeve/rreshtave, sipërfqaqe minimale 0.45Ha;
- Parcelsa e mbjellë me perime në fushë të hapur duhet të jetë së paku 0.05/ha e pandarë, në serra 0.05ha, me bimë aromatike mjekësore 0.03ha ndërsa pemishte 0.40 Ha;
- Sipërfaqja maksimale e perimeve njëkulturë duhet të jetë 0.05ha;
- Nuk kanë të drejtë përfitimi fermerët dhe anëtarët e ngushtë në bashkësi familjare, të cilët kanë përfituar mekanizëm të njëjtë (motokultivator) nga Komuna ose donatorët në bashkëpunim me Komunën në 3 (tri) vjetët e fundit;
- Nuk mund të janë përfitues më shumë se një antëtar i bashkësisë familjare;
- Fermerët të cilët nuk e kanë pronën në pronësi familjare, por shfrytëzojnë toka më qira, duhet të kenë marrëveshjen kontraktuese të nënshkruar nga të dy palët të noterizuar, në kohëzgjatje për tri (3) vjet;
- Nuk kanë të drejtë përfitimi fermerët dhe anëtarët e ngushtë në bashkësi familjare, të cilët kanë përfituar mekanizëm bujqësor nga Komuna ose donatorët në bashkëpunim me Komunën në vitin 2023.

### **Kriteret specifike:**

- Fermerët me sipërfaqe më të madhe, kanë përparësi në raport me ata që kanë sipërfaqe më të vogël të punuar;
- Të kenë njohuri elementare në fushën përkatëse;
- Fermerët me përgatitje profesionale shkollore (shkolla e mesme-bujqësore, fakulteti përkatës);
- Fermerët të cilët kanë ndjekur trajnime përkatëse;
- Gratë fermere dhe grupet e marginalizuara;
- Prona në pronësi të aplikuesit (fermerit);
- Prona e marrë me qira;
- Fermerët të cilët nuk kanë qenë asnjëherë përfitues të pajisjeve (mekanizmit bujqësor) nga Komuna ose donatorët në bashkëpunim me Komunën, do të kenë përparësi.

### **Dokumentacioni i nevojshëm:**

- Numri identifikues i fermerit (NIF);
- Kopja e një dokumenti identifikues të Republikës së Kosovës;
- Certifikata mbi pronësinë e paluajtshme, në afat deri në një (1) vit;
- Kopja e planit, në afat deri në 1 vit;
- Vërtetimi mbi tatimin në pronë për vitin 2023;
- Dëshmi për përgaditje profesionale – trajnime;
- Marrëveshja në mes palëve (kontrata e qirasë).

### **VËREJTJE**

Nëse komisioni parasheh të nevojshme sjelljen e dokumenteve shtesë, të cilat mundësojnë zgjedhjen e përfituesit, aplikuesi (fermeri) është i obliguar t'i sjellë ato në afatin e caktuar, në të kundërtën e humb të drejtën për të qenë përfituesi i subvencionit (grantit).

**Data e aplikimit, prej 23.05.2023 deri më 06.06.2023**